

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.05.05.2021*

05.05.2021

Ora 13:16

RENDI I DITËS


**Projektvendimi “Për shqyrtimin e kërkesave ankimore nr.27, nr.28, nr.29,
nr.30, nr.31, subjektet ankuese të 5 KZAZ-ve të ndryshme”.**

PJESËMARRJA :

- **KAS:** **Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA,**
Z.Illirjan RUSMALI, Z.Koli BELE
Stafi KQZ: Y.Merkaj, O. Peto

Z. E.Çefa: Mirëdita të gjithëve! Fillojmë seancën e KAS-it “Për shqyrtimin e kërkesave ankimore 27, 28, 29, 30, 31”. Kjo seancë do të drejohet nga unë në cilësinë e relatorit sipas shortit të hedhur ditën e djeshme. Janë prezent 4 anëtarët e KAS. Në këtë kontekst kurumi është i formuar dhe nuk kemi pengesë ligjore për të vazhduar seancën. Është prezente Administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Nuk ka prezencë nga palët e interesuara, pra anëtarët e KZAZ-ve nr. 66, nr. 38, nr. 2, nr. 20 dhe numër 21. Kjo gjithashtu nuk përbënë pengesë për të vazhduar seancën në mungesë të tyre. Shkurtimisht do të relatoj objektin e kësaj kërkesë ankimore. Pra, kërkesa ankimore nr. 27, datë 30.04.2021 është bërë nga anëtarët e KZAZ-së nr. 66, Berat kundër vendimit të Komisionerit Shtetëror nr. 306, datë 26.04.2021. sipas ankuesëve vendimi duhet shfuqizuar, sepse është i padrejtë për shkak se ka pasur difekt në printerin e KZAZ-së. Çka ka shkakuar vonesa në punën e kësaj KZAZ-je. Po ashtu, Kryetari i KZAZ-së ka shfaqur probleme shendetësore dhe është dashur zëvendësimi i tij nga Komisioneri. Si edhe efekti stresues nga ngjarjet e më sipërme dhe nga vetë natyra dhe procesi i punës me orar të

*Zbardhë materialin audio
Jonida SAJILLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.05.05.2021*

tejt zgjatur ka ndikuar sipas ankimuesëve në vonesa. Të cilat Komisioneri me vendimin objekt ankimi ka konsideruar që përbëjnë shkelje të ligjit dhe për këtë i ka sanksionuar me gjobë. Në kërkesën ankimore nr. 28 është bërë ankim nga anëtarët e KZAZ-së nr. 38, Tiranë kundër vendimit të Komisionerit nr. 318, datë 26.04.2021. Shkurtimisht argumentat që ngrenë ankuesit në ankimin e tyre janë se KZAZ ka bërë emërimin e numëruesëve dhe ka njoftuar partitë politike për t'u paraqitur në numërim. Më pas është vullneti i partive politike për t'i mbajtur numëruesit në tavolina. Pra, anëtarët e KZAZ-së pretendojnë se ato nuk mund t'i mbajnë kundër vullnetit të tyre numëruesit me detyrim në vendin e numërimit. Kjo sipas tyre përbën edhe arsyen pse janë shkaktuar vonesa. Në kërkesën ankimore nr. 29 e bërë nga anëtarët e KZAZ-së nr. 2, Shkodër kundër vendimit nr. 313, datë 26.04.2021 ngrihen argumenta sipas ankuesëve që puna ka qenë e pandërprerë. Por, pak e ngadaltë dhe për shkak të lodhjes së madhe dhe procedurave të shumta që ka procesi. Nga ana jonë pretendojnë ankuesit është punuar intensivisht edhe gjatë natës brenda limiteve normale. Në këtë kontekst kundërshtojnë vendimin e Komisionerit duke pretenduar që kanë justifikim. Pra, kanë shkaqe të arsyeshme për vonesat e shkaktuara dhe në këtë konteskt gjoba e dhënë nga Komisioneri kundrejtë tyre duhet të anulohet. Në kërkesën ankimore nr. 30, të bërë nga anëtarët e KZAZ-së nr. 20, Durrës kundër vendimit nr. 307, datë 26.04.2021 të Komisionerit Shtetëror. Ngrihen një sërë argumentash. Ndër të cilët shkurtimisht citoj se, sipas ankimuesëve nuk ka asnjë shkelje në frymën e ligjit. Pasi sipas tyre janë realizuar cilësisht dhe me transparencë detyrat që ligji i ka ngarkuar KZAZ-së. Afati nuk është respektuar thonë ankimuesit për shkaqe që nuk varen nga ne. Ka ndikuar në këtë afat numri i madh i qendrave të votimit dhe kushtet e limituara të ambienteve në vendin e numërimit të votave. Marrja në

*Zbardhi materialin audio
Jonida SALILLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.05.05.2021*

dorëzim e aparaturës PEI. E cila ishte një risi gjatë këtij procesi ka kërkuar kohë shtesë sipas ankimuesëve dhe për këtë arsye ata i kanë kushtuar më shumë vëmendje. Pra, për ata ka qenë më i rëndësishëm përmbyllja cilësore e procesit se sa ngutja duke rrezikuar edhe krijimin e ndonjë lapsusi apo ndonjë gabimi që mund të ndikonte në rezultat. Po ashtu, edhe si argument tjetër shtesë i vonësive është edhe lodhja dhe pagjumësia dhe ulja e rezistencës fizike tek numëruesit që ka ndikuar drejtpërdrejtë pastaj dhe në vonesa. Edhe këta ankimues pretendojnë që vendimi i Komisionerit është i kundërligjshëm dhe duhet të shfuqizohet. Në kërkesën akimore të fundit që është ajo me nr. 31 e bërë nga anëtarët e KZAZ-së nr. 21, Durrës kundër vendimit të Komisionerit nr. 308, datë 26.04.2021 është ngritur argumenti sipas tyre që vendimi i Komisionerit duhet të shfuqizohet si i kundërligjshëm pasi ne kemi në administrim 108 qendra votimit. Të cilat janë në një distancë të konsiderueshme. Madje shkojnë edhe në 45 km nga vendi i numërimit të votave. Çka ka ndikuar drejtpërdrejtë në vonesat në proces. Sipas tyre procesi i numërimit nuk ka filluar siç ishte parashikuar në orën 22:00 , por ka filluar në orën 3:00, të datës 16 Prill. Këto janë shkurtimisht edhe argumentat e ngritura në të 5-të këto kërkesa akimore. Të cilat janë bashkuar me vendimin e djeshëm të ndërmjetëm të KAS-it në një ankim të vetëm. Nga kolegët ndonjë pyetje për Administratën? Nuk kemi. Atëherë, e konsiderojmë hetimin administrativ të përfunduar. KAS do të tërhiqet për të marrë vendim.

*Zbardhi materialin audio
Jonida SALILLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.05.05.2021*

Rifillon seanca

Ora 13:24

Z. E.Çefa: Atëherë, KAS i konsultuar në vend, vendosi:

1.Pranimin e kërkesave ankimore nr. 27, 28, 29, 30, 31 të anëtarëve dhe sekretarëve përkatësisht të KZAZ-ve, KZAZ nr. 66 Qarku Berat, KZAZ nr. 38 Qarku Tiranë, KZAZ nr. 2 Qarku Shkodër, KZAZ nr. 20 Qarku Durrës dhe KZAZ nr. 21 Qarku Durrës.

2.Shfuqizimin e vendimeve nr. 306, 318, 313, 307 dhe 308, atë 26.04.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe heqjen e sanksionimit administrativ ndaj anëtarëve dhe sekretarëve të KZAZ-ve të më sipërme.

3.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë brenda 45 ditëve.

Seanca deklarohet e mbyllur.

Vendimi nr.55

*Zbardhi materialin audio
Jonida SALILLARI*

